



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

-----Organi Shqyrtues i
Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë

Tel: + 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 2025/0095

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi – Kryetar, Kimete Gashi dhe Batisha Ibrahim- Anëtare duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "Patroni" Sh.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A. në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me lëndë djegëse për kaldajë – mazut (Fuel Oil 1.0%)" me numër të prokurimit KEK-24-186-1-1-1, në **rivendosje** sipas Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale nga Dhoma e Shkalles së Parë KA. nr. 210/25 si dhe Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale nga Dhoma e Shkalles së Dytë me numër K.DH.SH.II.nr.907/25 (2025:077507), më datën 18.09.2025, mori këtë:

VENDIM

1. Anulohet, B58 Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me lëndë djegëse për kaldajë – mazut (Fuel Oil 1.0%) me numër të prokurimit KEK-24-186-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Korporata Energjetike e Kosoves Sh.A ndërkaq aktiviteti i prokurimit i lartë përmendur kthehet në rivlerësim.
2. Shqiptohet gjoba në të holla për Autoritetin Kontraktues në lartësi të shumë 10.000,00 €, për shkak të mosrespektimit të Vendimit të OSHP (Protokoll 2024/0513) të datës 19.08.2024, dhe Vendimit të OSHP (Protokoll 2024/0970) të datës 11.12.2024, në pajtim me nenin 131, të Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës. Obligohet Autoriteti Kontraktues që ne afat prej 10 diteve nga dita e pranimit të këtij Vendimi ta kryej obligimin financiar në xhirrollogarine bankare të OSHP me nr. 1000430070005756.

3. Inicohet procedura për revokimin e certifikatës së prokurimit ndaj zyrtarit përgjegjës të prokurimit të AK (menaxherit të prokurimit), sipas dispozitës së nenit 25, paragrafit 8 të LPP.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me datën: 05/02/2025, OE Patroni Sh.P.K, ka ripërsëritur ankesën në OSHP kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit: Furnizim me lëndë djegëse për kaldajë – mazut(Fuel Oil 1.0%) me numër të prokurimit KEK-24-186-1-1-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues, "Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A".

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedura të hapur, lloji i kontratës furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 6,650,000.00 €.

-Vlerësimi dhe administrimi i provave -

OSHP ka angazhuar ekspertin shqyrtues të prokurimit që në pajtim nenin 113 të LPP-së, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore i cili në raportin e datës 21/02/2025 ka rekomanduar që:

- Të aprovohet ankesa e OE ankues, si dhe
- Kjo çështje sipas ekspertit është çështje e gjykuar

Përgjigje në pretendimet ankimore Patroni Sh.P.K:

Sqarim për PSH: Eksperti shqyrtues sqaron se AK përkundër vendimit të PSH 2024/0970, ka kthyer aktivitetin e prokurimit në rivlerësim dhe gjatë rivlerësimit me anë të kërkesës për sqarim ka kërkuar ekspertizë të grafologjisë të cilën ekspertizë OE i rekomanduar e ka dërguar me datën 21.02.2025 nga eksperti i grafologjisë e bashkangjitur edhe ne ankesë.

Konstatimi i ekspertit shqyrtues: “Eksperti shqyrtues sqaron se pretendimet e OE ankues ne këtë aktivitet të prokurimit janë pretendimet e njëjta të cilat janë trajtuar edhe ne vendimin e PSH 2024/0513 dhe 2024/0970. Pas administrimit të provave, vendimet e PSH eksperti shqyrtues vlerëson se për aktivitetin e prokurimit dhe pretendimet e OE ankues për këtë aktivitet të prokurimit janë marrë dy vendime të OSHP-se, ndërsa duke ju referuar vendimit 2024/0970 citoj

“Paneli vlerëson se Autoriteti Kontraktues - “Korporata Energjetike e Kosovës” sh.a, zyrtari përgjegjës i prokurimit dhe komisioni i ri-vlerësimit gjatë vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve, nuk e ka marrë për bazë fare Vendimin e OSHP- së nr. 2024/0513 të datës 19.08.2024, ku në bazë të këtij vendimi konkretisht në faqen 10, PSH konstaton se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit dhe AK të veproj konform nenit 52.7 të LPP. Rrjedhimisht, AK pasi që ka kthyer lëndën në ri-vlerësim, prapë e shpallë OE e njëjtë të rekomanduar për kontratë që sipas vendimit të OSHP i cila ka marrur formën e prerë është i papërgjegjshëm. Me këtë rast AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 97 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik, ku sipas këtij neni tek pika h), Mos respektimi i vendime të OSHP,

konsiderohet shkelje e rëndë në Prokurimin Publik”. Prandaj duke ju referuar vendimit të PSH 2024/0970 eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimet e trajtuara në këtë aktivitet të prokurimit janë të njëjta dhe për këto pretendime janë nxjerre dy vendime të cilat në të dy rastet është vlerësuar se “OE i rekomanduar për kontratë e ka marrë formën e prerë se është i papërgjegjshëm” prandaj duke u bazuar në vendimet e mëparshme për çështjet e njëjta eksperti shqyrtues vlerëson se këto pretendime duhet të konsiderohen si çështje të gjykuara “res judicata”. Përfundimisht bazuar në nenin 119 të LPP-se si dhe sqarimet e dhëna përmes emailimit të OSHP-se të datës 20.09.2024 vendimet e PSH - OSHP-së, janë të plotfuqishme dhe të njëjtat mund të atakohen në gjykatë sipas këshillës juridike vetëm nga palët e pakënaqur, prandaj eksperti shqyrtues vlerëson se këto pretendime duhet të konsiderohen si çështje të gjykuara “res judicata.”

Lidhur me vendimin e OSHP nr. 2025/0095 Me datë 15.04.2025, në Gjykatën Komerciale, Departamenti për Çështje Administrative ka parashtruar padi Korporata energjetike e Kosovës KEK Sh.A për anulim i vendimit me numër OSHP:2025/0095 të datës 03.04.2025, me propozim për shtyrje të ekzekutimit të këtij vendimi.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative me datën 30.04.2025 ka aprovuar padinë e paditësit KEK Sh.A dhe ka shtyrë zbatimin e vendimit të kundërshtuar OSHP: 2025/0095 të datës 30.04.2025. Në këtë aktvendim Gjykata thekson se vendimi i Organit Shqyrtues të Prokurimit është i paqartë dhe kundërthës në pjesën e dispozitivit. Rrjedhimisht në rastin në fjalë vendimi i OSHP-së, duhet të përmbaj një dispozitiv të qartë.

OSHP në cilësi të kundërpropozuesesit/të paditurit kundër aktgjykimit, si dhe kundër aktvendimit për shtyrje të ekzekutimit në afat ligjor ankesë ka ushtruar e paditura për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës administrative, aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Ka propozuar aprovimin e ankesave dhe prishjen e aktgjykimit, respektivisht aktvendimit.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e Shkallës së Dytë me datën 23.07.2025 me Aktgjykimin K.DH.SH.II.nr.907/25 ka refuzuar ankesën e të paditurit OSHP duke lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë për rivendosje duke potencuar se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka gjetur shkelje ligjore në procesin e vendimmarrjes së OSHP e cila si organ administrativ i shkallës së dytë në procedurën e prokurimit, deri të vendimi kontestues ka ardhur me një sërë lëshimesh procedurale. Fillimisht, duhet vënë theksin në faktin se dispozitivi i aktvendimit të atakuar në këtë konflikt administrativ përmban të meta serioze për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohet. Si i tillë formulimi i dispozitivit në pikën 3 është i pazakontë dhe jo-përmbajtësor.

Konform Aktgjykimit KA.nr.210/25 të datës 30.04.2025 dhe Aktgjykimit K.DH.SH.II.nr.907/25 të datës 23.07.2025 të pranuar me datën 28. 08. 2025. Paneli Shqyrtues rivendos në këtë vendim duke i përmirësuar të metat e konstatuara nga këto aktvendimeve të gjykatës.

Paneli Shqyrtues konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme për të vendosur sipas paragrafit 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar.

Paneli në këtë rast mori në konsideratë të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK dhe raportin e ekspertit. Në fakt (natyrisht pavarësisht nga rekomandimet) Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në këtë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertizës së ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik.

Prandaj Paneli konstaton se këto pretendime janë gjykuar edhe me vendime paraprake, andaj si të tilla konform neni 105 paragrafi 2.16 i LPP-së sqaron: “Në rastet e përsëritura me të njëjtat pretendime ankimore, ku objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, në rastet të cilat janë shqyrtuar më parë, Kryetari i Panelit Shqyrtues i trajton si çështje të gjykuara “res judicata”. Andaj, mbi bazën e kësaj PSH vendos për të anuluar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues “Korporata Energjetike e Kosovës” lidhur me aktivitetin “FURNIZIM ME LËNDË DJEGËSE PËR KALDAJË – MAZUT(Fuel Oil 1.0%)” me numër të prokurimit KEK-24-186-1-1-1, dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Paneli konstaton se Autoriteti Kontraktues - “Korporata Energjetike e Kosovës” sh.a, zyrtari përgjegjës i prokurimit dhe komisioni i ri-vlerësimit gjatë vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve, nuk e ka marr për bazë fare Vendimin e OSHP- së nr. 2024/0513 të datës 19.08.2024, si dhe vendimin nr. 2024/0970 të datës 11.12.2024. Në bazë të vendimit nr. 2024/0513 konkretisht në faqen 10, PSH konstaton se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit dhe AK të veproj konform nenit 52.7 të LPP. Si dhe me vendimin 2024/0970 PSH ka konstatuar se kjo pretendime të trajtohet si çështje e gjykuar dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim, Me çrast OSHP-ja urdhëron Autoritetin Kontraktues (AK) - “Korporata Energjetike e Kosovës” sh.a, që të ndërmarr masa për zbatimin e vendimit të lartpërmendur në afat prej pesë (5) ditësh, mos respektimi i këtij urdhri, në afat prej pesë ditësh kalendarike, do ta detyrojë panelin shqyrtues që të respektoj nenin 131 të LPP-së dhe njëkohësisht do të kërkojë nga KRPP-ja që ti anulojë licencën menaxherit të prokurimit të Autoritetit Kontraktues (AK) - “Korporata Energjetike e Kosovës” sh.a, në pajtim me nenin 25 paragrafi 8 dhe 9 të LPP-së.

Pas analizimit të shkresave të lartpërmendura të cilat i kishte në dispozicion Paneli Shqyrtues, si: Ankesat e OE ankues, raportet e ekspertit shqyrtues, vendimin nr.2024/0513, nr. 2024/0970, shihet se AK përsëri nuk kishte zbatuar vendimet dhe urdhëresën e OSHP përderisa, vendimet e OSHP-së janë të detyrueshme për autoritetet kontraktuese dhe të gjitha palët në procedurë, dhe se kundër vendimeve të OSHP-së, palët mund të ankohen në gjykatën kompetente brenda afatit ligjor me mjete të rregullta juridike, në përputhje me këshillën juridike të dhënë në vendim.

Rrjedhimisht, AK ka kthyer lëndën në ri-vlerësim dhe përkundër faktit se OSHP me dy vendime e ka kualifikuar OE të rekomanduar të papërgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit, si dhe përkundër urdhrit të cekur në pikën 3 të dispozitivit të vendimit nr, 2024.0970, AK shpallur prape

OE e njëjtë fitues, citat pika 3 e dispozitivit: “*URDHËROHET Autoriteti Kontraktues- “Korporata Energjetike e Kosovës” sh.a., që në afat prej 5 (pesë) ditësh kalendarike të njoftoj OSHP-në lidhur me zbatimin e vendimit të OSHP-së: PSh.nr.2024/0513 i datës 19.08.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “FURNIZIM ME LËNDË DJEGËSE PËR KALDAJË – MAZUT(Fuel Oil 1.0%)” me numër të prokurimit KEK-24-186-1-1-1*”.

Vlen të theksohet se këto dy vendime të lartcekura të OSHP kanë marrë formën e prerë ngase të njëjtat nga asnjëra palë nuk janë atakuar në gjykatë. Me këtë rast AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të prokurimit publik (LPP) si dhe në kundërshtim me nenin 97 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik, ku sipas këtij neni tek pika h), Mos respektimi i vendime të OSHP, konsiderohet shkelje e rëndë në Prokurimin Publik.

Paneli Shqyrtues thekson se vendimin e OSHP kanë pasur mundësi ta atakojnë në Gjykatën kompetente konform këshillës juridike të dhënë në vendim por edhe konform nenit 99, paragrafit 3 të LPP, citat: “*Të gjitha vendimet e nxjerra nga OSHP mund të shqyrtohen nga Gjykata kompetente në pajtim me ligjin për shqyrtimin gjyqësor të çështjeve administrative*”. Pikërisht ligjvënësit në të gjitha sistemet juridike kanë lënë mundësinë që nëse, ndonjëra palë në procedurë konsideron se vendimi i OSHP nuk është marrë konform dispozitave ligjore atëherë të atakohen në gjykatë dhe gjykata ka edhe mundësinë qoftë të lë në fuqi vendimin e OSHP, qoftë, lëndën ta kthen mbrapa në OSHP për ri-vendosje.

Përveç tjerash OSHP-në edhe Gjykata evropiane e drejtësisë e njeh si kauzi-gjykatë, e po ashtu edhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës në Aktgjykimin e saj me nr. referent AGJ 2459/24, në rastin nr. KO157/23, në pikat 133 dhe 134, thekson se vlerësimi i vendimeve të OSHP i takon vetëm gjykatave të Republikës së Kosovës. Nisur nga kjo vlerësimin e vendimeve të OSHP nuk mund ta bëjë AK sikurse në këtë rast por as vet Paneli Shqyrtues.

Që do të thotë që pas vendimeve të OSHP, autoriteti kontraktues ka pasur disa mundësi:

- Ta atakoj vendimin e OSHP në Gjykatë
- Të bëjë vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e ofertave të OE të cilët janë palë me interes konform nenit 59 të LPP.

Por në asnjë mënyrë nuk ka pasur të drejtë të shpall prapë fitues OE i cili me vendime të OSHP ka rezultuar i papërgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit.

Këto vendime OSHP është bazuar edhe në opinionet e KRPP në lidhje me autorizimet për nënshkrim të dokumenteve të tenderit, ku KRPP ka lëshuar një opinion me dt. 24.10.2023 tek pyetjet e shpeshta përkatësisht pyetja me nr.14.

Po ashtu, OSHP ka obliguar AK të ndërmarrë veprime konform nenit 52.7 të LPP, lidhur me këto nënshkrime të dyshimta dhe AK në vend që të bëjë një kontroll efektiv dhe normalisht që lëndën ta dërgoj tek organet gjegjëse të hetuesisë, AK me dt. **16.01.2025** në ora **14:59** kërkon nga OE i rekomanduar për kontratë që të angazhoj një ekspert të grafologjisë për të vërtetuar këto nënshkrime.

Me çrast OE i rekomanduar për kontratë po të njëjtën datë **16.01.2025**, gjene ekspertin teknik të grafologjisë, i cili ekspert në faqen e dytë të këtij akti të ekspertimit thekson se numri referues i ekspertimit dhe datat e marrjes së materialeve është bërë po me datë **16.01.2025**. Ky veprim në mes të AK dhe OE të rekomanduar për kontratë i ngjanë shumë se ky veprim ka qenë veprim i koordinuar në mes tyre, në të kundërtën është pothuajse e pamundur që thuajse në fund të orarit të punës të kryhen të gjitha këto veprime, të kërkohen sqarime nga OE dhe OE menjëherë të gjenë ekspertin teknik, të d'akordohen rreth kërkesë së AK dhe punës të cilën duhet ta kryej ky ekspert dhe të dorëzohet materiali dhe të fillohet puna e hartimit të këtij raporti nga ana e ekspertit të grafologjisë.

Përveç tjerash, OSHP thekson se nuk ka qenë kërkesë e vendimeve paraprake të saj të bëhet një raport nga ndonjë ekspert i grafologjisë nga ana e OE të rekomanduar, këtu kemi një devijim komplet nga ajo që është theksuar në vendimet e OSHP. Raporti i grafologjisë, PSH vlerëson se kjo ka qenë dashtë bëhet shumë më herët nga vetë AK apo nga ndonjë institucion i organeve gjegjëse të hetuesisë, edhe para se lënda të arrij në OSHP pas kërkesës për ri-shqyrtim me çrast AK edhe ka mundur të njoftohet përherë të parë nga ankuesi, e jo sikurse në këtë rast kemi të bëjmë me ekspertizë të grafologjisë që është hartuar nga OE i rekomanduar për kontratë, e që nënkupton se nuk kemi një ekspertizë institucionale dhe e cila mund të mos jetë objektive.

Më pastaj ekspertiza është bërë për katër dokumente të cilat i janë ofruar ekspertit ana e OE të rekomanduar për kontratë, e të cilat dokumente mbajnë datë të mëvonshme se sa hapja e tenderit për të cilin po kontestohen nënshkrimet, e ku nuk dihet se cili nënshkrim është origjinal i Fatbardh Muharremi, sepse ekspertit ka mundur ti ofrohen dokumente të cilat janë të nënshkruara për Fatbardh Muharremi nga dikush tjetër në procedurat e mëvonshme të prokurimit.

Hapja e tenderit është bërë me dt.27.02.2024, ndërsa dokumentet që i janë ofruar OE të rekomanduar për kontratë janë dokumente që mbajnë data të mëvonshme se sa 27.02.2024, e që nënkupton se nuk është marr një mostër e nënshkrimit origjinal e Fabardh Muharremi nga e kaluara, prandaj nuk mund të bëhen konstatime objektive të nënshkrimit të këtij personi.

PSH konsideron se për të pasur një ekspertizë profesionale dhe objektive është dashur të ekzaminohet nënshkrimi i Fatbardh Muharremi i vendosur tek dokumentet zyrtare personale që i ka nënshkruar ky person e këtu mund të hyjë nënshkrimi tek letërnjoftimi apo pasaporta dhe të krahasohet me nënshkrimet e paraqitura tek tenderi përkatës. Vlen të shikohen dallimet e mëdha në nënshkrimet e këtij personi të cekura në vendimin 2024/0513.

Nënshkrimi është një akt personal dhe vullnetar që tregon se personi ka marrë pjesë aktivisht në procesin e krijimit të dokumentit dhe ka të kuptuar çdo term dhe kushte të tij. Nënshkrimi nuk mund të bëhet pa u menduar mirë ose pa u dhënë pëlqimi, përkundrazi, ai është një pasqyrë e qartë e një vendimi të informuar. Ky është një mekanizëm që ndihmon për të siguruar që individët të jenë të vetëdijshëm për veprimet që ata po ndërmarrin dhe pasojat që mund të vijnë nga këto veprime.

Edhe në këtë rast emri, mbiemri dhe të dhënat e drejtorit L. M. Dhe nënshkrimi i personit tjetër pa i vendosur fjalën “për” ky konsiderohet dokument i parregullt dhe kjo kualifikohet si kusht administrativ dhe PSH këtë veprim të OE të rekomanduar për kontratë nuk e sheh si të rastësishme,

sepse, në rastet kur lind një konflikt apo mosmarrëveshje, nënshkrimi shërben si provë që një person ka pranuar, miratuar ose angazhuar veten për diçka.

Për të ruajtur besueshmërinë dhe legjitimitetin e dokumenteve zyrtare, është thelbësore që ato të nënshkruhen nga individët e përfshirë. Pa nënshkrimin e duhur, dokumentet mund të konsiderohen të pavlefshme, dhe marrëveshjet që mund të kenë pasuar mund të shkelin ligjet përkatëse.

Në përfundim, nënshkrimi i një dokumenti ka shumë rëndësi dhe është një akt që nuk duhet të merret lehtë. Ai ka efektet ligjore dhe shoqërore të cilat i japin asaj një fuqi dhe vlefshmëri të paçmuar. Ky është një mjet i domosdoshëm për të garantuar sigurinë, ligjshmërinë, dhe ndershmërinë e marrëdhënieve ndërmjet individëve dhe institucioneve.

Paneli po ashtu mori vendim:

- Që të shqiptohet gjoba në të holla për Autoritetin Kontraktues në lartësi të shumë 5.000,00 €, për shkak të mosrespektimit të Vendimit të OSHP të datës 19.05.2023, në pajtim me nenin 131, të Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës;

-Të Inicohet procedura për revokimin e certifikatës së prokurimit kundër zyrtarit përgjegjës të prokurimit të AK, konform nenit 25, paragrafi 8, të LPP, për shkak të shkeljeve të dispozitave ligjore të lartcekura si dhe nenit 97 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

Me vendimet nr. 2024/0513 të dates 19.08.2024, dhe nr. 2024/0970 të datës 11.12.2024, OSHP ka kërkuar që AK ta rivlerësoj aktivitetin e prokurimit në kuptim të rrethanave të shpjeguara në këto vendime (pa nevojë të përsëriten). Në këtë rast, është jokontetuese se AK nuk ka vepruar në harmoni me Vendimet e cituara, të cilat në kuptim të legjislacionit nënkupton aktin administrativ të një organi kompetent, me efekte detyrues për të gjitha palët meqë i njëjti buron nga normat kogente të LPP dhe kompetencat e OSHP, nga cilësia e tij si organ i administratës shtetërore në shkallë të dytë. Paneli konsideron (pa ndonjë paragjykim) se, përfillja e Vendimit të cituar do evitonte në kohë efektive çdo dilemë, në relacion me kërkesat e parapara. Andaj, edhe në pikën 3 të dispozitiv të vendimit nr. 2024/0970 është vendosur urdhëresa për AK, citat: *“URDHËROHET Autoriteti Kontraktues- “Korporata Energjetike e Kosovës” sh.a., që në afat prej 5 (pesë) ditësh kalendarike të njoftoj OSHP-në lidhur me zbatimin e vendimit të OSHP-së: PSh.nr.2024/0513 i datës 19.08.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “FURNIZIM ME LËNDË DJEGËSE PËR KALDAJË – MAZUT(Fuel Oil 1.0%)” me numër të prokurimit KEK-24-186-1-1-1”*.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

- Përfundim –

Duke u bazuar në kompetencat e OSHP të rregulluara sipas nenit 105, lidhur me nenin 106 të LPP, Paneli Shqyrtues vuri në zbatim mes tjerash dhe nenin 103 të Ligjit të cituar sipas të cilit të gjitha palët e interesuara do të kenë qasje të barabartë në procedurat për shqyrtimin e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se, asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret ose bëhet në mënyrën me të

cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një pjesëmarrësi në procedurë ose të një personi ose ndërmarrje tjetër. Prandaj nisur nga të lartcekurat Paneli Shqyrtues ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi i bindur se ka aplikuar zgjidhjen e duhur.

Paneli Shqyrtues i OSHP, kërkon nga AK që në procesin e rivlerësimit të aktivitetit të prokurimit të evitohen shlejet e cituara si më sipër dhe vlerësimi të bëhet konform nenit 59 të LPP.

Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Anëtar të Panelit
Kimete Gashi

Anëtare të Panelit
Batisha Ibrahim



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A
- 1x1 OE Patroni Sh.P.K
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.